

L I G J Nr.9318,

datë 18.11. 2004

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8615, DATË 1.6.2000 "PËR URDHURIN E MJEKËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8615, datë 1.6.2000 "Për Urdhrit e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Paragrafi i parë i nenit 9 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli Kombëtar përbëhet nga 21 anëtarë. Në këtë Këshill bëjnë pjesë detyrimisht: Presidenti dhe Zëvendëspresidenti i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve, presidentët e këshillave rajonale të Urdhrit të Mjekëve, një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë, një përfaqësues i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, një përfaqësues i Ministrisë së Financave, një përfaqësues i Fakultetit të Mjekësisë, një përfaqësues i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe dy përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse."

Neni 2

Paragrafi i dytë i nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli rajonal zgjedh presidentin dhe zëvendësit e tij. Mandati i presidentit është 5 vjet, me të drejtën e një rizgjedhjeje."

Neni 3

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 16

Shteti i jep Urdhrit të Mjekëve një mbështetje buxhetore, në formë transferte, për vitet 2004 e 2005."

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4419, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Aldred Moisiu